

VENDIM
Nr. 78/2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 96/2014 “PËR KRIJIMIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN NË SISTEMIN E DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit dhe të pikës V të vendimit të Kuvendit nr. 96/2014, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, bëhet ky ndryshim:

I. Pika III ndryshohet si më poshtë:

“III. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 10 anëtarë, nga të cilët 5 janë përfaqësues të shumicës parlamentare (4 PS dhe 1 LSI) dhe 5 të pakicës parlamentare (4 PD e 1 PR). Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.”.

II. Pika VI ndryshohet si më poshtë:

“VI. Komisioni i Posaçëm organizon dhe zhvillon veprimtarinë e tij mbështetur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit për funksionimin e komisioneve parlamentare. Përjashtimisht, në rastet e mungesës së kuorumit, mbledhja e Komisionit zhvillohet me praninë e njërit prej anëtarëve zëvendësues. Përjashtimisht, në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e Kryetarit të Komisionit është vendimtare, duke respektuar në çdo vendimarrje standardet ndërkombëtare të transparencës e gjithëpërfshirjes, në konsultim me ekspertizën ndërkombëtare, përfshirë dhe Komisionin e Venecias.”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.7.2015